RisiAlbania
Partner for Growth

BULETINI INFORMATIV

Nr. 16, janar - mars 2018

Nxisim zhvillimin ekonomik dhe krijimin e vendeve të punës për të rinjtë në Shqipëri

Në një ceremoni të posaçme të organizuar në mjediset e Qendrës për Hapje dhe Dialog, Zv. Kryeministrja Senida Mesi dhe Shefja e Departamentit për Bashkëpunimin me Evropën Lindore në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Zvicrës Ambasadorja Ruth Huber, firmosën më 23 mars 2018 marrëveshjen për fazën e II-të të projektit Risi Albania. "Risi Albania do të punojë për ta bërë tregun e punës tërheqës për djemtë dhe vajzat e reja përmes 3 strategjive; së pari duke ndihmuar kompanitë dhe bizneset të rriten dhe të krijojnë vende pune për të rinjtë, së dyti duke u ofruar të rinjve informacion dhe ndërmjetësim, duke i lidhur ata me tregun e punës dhe së treti duke përmirësuar njohuritë dhe aftësitë sipas kërkesave të tregut, në mënyrë që të pajisin të rinjtë më aftësitë e nevojshme për tu punësuar", tha gjatë fjalës së saj Ambasadorja Huber. Zv.Kryeministrja Mesi theksoi se projekti Risi Albania ka në fokus punësimin e të rinjve në sektorët si inovacion, bujqësi, zhvillim rural dhe turizëm dhe ai i përgjigjet më së miri prioritetit të qeverisë shqiptare – punësimit. "Si rezultat ne besojmë se ky projekt do të ndihmojë qeverinë shqiptare të arrijë këtë objektiv", vlerësoi ajo.

RISI ALBANIA
FAZA II (2017-2021)

OBJEKTIVAT

1,600
VENDE TË REJA PUNE

3,000
NDËRMJETËSIME

+

600
PUNËSIME

RisiAlbania
Partner for Growth

Mbështetur nga:
Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra
Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

Zbatuar nga:
HELVETAS Swiss Intercooperation ALBANIA
PARTNERSALBANIA FOR CHANGE AND DEVELOPMENT

Zhvillimi i produkteve të reja turistike në Shqipërinë e Jugut

Operatorë turistikë, përfaqësues të qeverisë vendore, akademisë, dhe ekspertë të turizmit u mblodhën më 15 mars për të diskutuar mbi krijimin dhe zhvillimin e e produkteve të reja turistike, paketave turistike që lidhen ekoturizmin, turizmin e aventurës, kulinarisë, dhe atë historik në qarkun e Gjirokastrës dhe në jug të vendit.

Gjatë aktivitetit Risi shpalli thirrjen për propozime të reja për të zhvilluar ide që i shtojnë vlerë turizmit dhe që sjellin vëmendje në çështjet që lidhen me sezonalitetin dhe nxitjen e krijimit të vendeve të punës. Në të njëjtën linjë me prioritetet e qeverisë shqiptare, thirrja inkurajon tur-operatorët të sjellin projekt-propozime në lidhje me zhvillimin e produkteve në zonat e përfshira në strategjinë e "100 fshatrave".

Pjesëmarrësit vlerësuan nevojën për të diversifikuar ofertën turistike dhe kërkuan një bashkëpunim më të mirë mes aktorëve vendas dhe kombëtarë në fushën e turizmit. "Ne duhet të punojmë së bashku për të diversifikuar ofertën turistike dhe për të rritur numrin e turistëve" tha Kristina Fidhi nga Karavan Horse Riding.

Operatorët turistikë kanë një rol kyç në krijimin e produkteve dhe ideve të reja si dhe në afrimin e të gjithë aktorëve për të zhvilluar dhe përmirësuar ekperiencën turistike që sjell zhvillim ekonomik dhe krijimin e vendeve të punës në Shqipëri.

Fuqizimi i ekonomisë vendore përmes kultivimit të bimëve aromatike dhe mjekësore

Përmes një thirrjeje për projekt-propozime Risi Albania synon të përshkallëzojë dhe të rrisë më tej suksesin e ndërhyrjes në sektorin e bimëve aromatike dhe mjekësore, i cili bazohet në përmirësimin e praktikave pas mbledhjes së bimëve.

Pas ndërhyrjes së suksesshme në Korçë me kompaninë Çibuku – një kompani private që shërben si pikë grumbullimi për këto bimë në rajon, projekti mbështeti 15 gra në fshatin Shelcan në Elbasan, duke bashkë-financuar pajisjet për tharrjen e bimëve. Falë kësaj ndërhyrjeje u ndihmuan fermeret të rrisin cilësinë e produktit dhe të plotësojnë kërkesat e tregut për standarte më të larta.

"Duke përmirësuar procesin e tharrjes së bimëve ne arritëm të sigurojmë një fitim më të madh nga 10-30% më shumë që gjatë të korrave të para"-thotë Margarita, një prej grave fermere të mbështetura, një ish emigrante e cila tashmë ka vendosur të kthehet dhe të zgjerojë biznesin e mbledhjes dhe kultivimit të bimëve aromatike dhe mjekësore.

Ne presim që këto iniciativa të sjellin përfitime për industrinë e bimëve aromatike dhe mjekësore.

Roli i medias në punësimin e të rinjve – model frymëzimi për projektin EYE në Kosovë

RisiAlbania *është një projekt inovativ që synon punësimin e të rinjve, i fokusuar në sjelljen e ndryshimeve sistematike në tregun shqiptar të punës, me qëllim përmirësimin e mundësive për punësim dhe të ardhura për të rinjtë e të rejat.*

Kohëzgjatja e projektit:
Faza I: Nëntor 2013 – Tetor 2017
Faza II: Nëntor 2017 – Tetor 2021

Rr. Ismail Qemali, P18, H.3, Apt. 15
Tirana, Albania
Tel : **+355 (0) 422 48 52**
E-mail: **info@risialbania.al**
www.risialbania.al

Gjatë vizitës 2-ditore në Shqipëri Dren Selimi menaxher pranë projektit "Rritje e Punësimit për të Rinjtë", EYE në Kosovë u njoh me programet mediatike, partnerët dhe disa nga përfituesit që ka mbështetur RisiAlbania përmes shpërndarjes së informacionit mbi tregun e punës dhe orientimit të karrierës.

"Një audiencë që nuk e kemi targetuar më parë, por besoj që tani pas kësaj vizite mund të adresohet pasi pamë që ka ndikim tek të rinjtë, është përmes radios"- thotë Dren pas vizitës në studiot e radios Club FM ku u njoh me programin e suksesshëm dhe me ndikim tek të rinjtë "Ora e punës".

Me shumë interes për RisiAlbania është Dialogu Social që EYE po mbështet në Kosovë mbi tema si paga minimale, sigurimet shoqërore, përfshirja e të rinjve në vendimarrje, çka do ti hapë rrugën shkëmbimeve të ardhshme mes projekteve.
Lexoni intervistën e plotë KETU

AKTIVITETET E ARDHSHME

27 prill 2018

Konkursi kombëtar "Festat Lokale"

Në 27 prill do të zhvillohet ceremonia e ndarjes së çmimeve për fituesit e konkursit "Festat Lokale".

Konkursi fton bashkitë të dorëzojnë projekt-propozimet për organizimin e aktiviteteve që do të promovojnë traditat e zonës, tërheqin turistët dhe krijojnë vende të reja pune.

Risi mbështet këtë inisiativë të përbashkët të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

Sesionet e Informimit : **6-7 prill**

27
PRILL

prill 2018

Tryezë e rrumbullakët për turizmin në Gjirokastër

Me kërkesë të aktorëve të ndryshëm që operojnë në fushën e turizmit dhe në bashkëpunim me Bashkinë, Risi do të organizojë një tryezë të rumbullakët me aktorët publikë dhe privatë në fushën e turizmit.

Synimi i kësaj tryeze është vlerësimi dhe shpërndarja e informacionit për secilin nga prioritetet e identifikuara dhe ndarja e përgjegjësive për çdo aktor.

2018
PRILL

maj 2018

Trajnim i trajnerëve

Risi Albania do të ofrojë mbështetje për shoqatën shqiptare të teknologjisë së informacionit, AITA për organizimin e sesioneve B2B dhe identifikimin e partnerëve me synimin për të forcuar rolin e shoqatës si koordinator dhe promovues i këtij biznesi.

2018
MAJ